

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
Direktoratë për Administratë dhe Personal
Direkcija za Administraciju i Personal

Nr.Br. 218 dt. 15 10 28
FUSHE KOSOVË-KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE /
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO POLJE



RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN DHE FUNKSIONIMIN E BASHKËSIVE VENDORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS

E MIRATUAR MË DATË: 15.10.2008.

Në bazë të nenit 12.2 dhe nenin 34.4, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, të datës 04 Qershor, nenit 14.5 të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 15.10.2008, miratoi:

RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN DHE FUNKSIONIMIN E BASHKËSIVE VENDORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullojë parashihet organizimi, struktura dhe funksionimi i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane që gravitojnë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 2

- 2.1 Bashkësitë vendore të Komunës së Fushë-Kosovës janë:
1. Bashkësia Vendore Bardh i Madh, përfshin fshatrat: Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Graboc i Poshtëm dhe Pomozotin;
 2. Bashkësia Vendore Sllatinë e Madhe, përfshin: fshatrat Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Harilaç dhe Henc;
 3. Bashkësia Vendore Vragoli, përfshin: fshatrat Vragoli, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme dhe Batushë.
- 2.2 Qyteza e Fushë-Kosovës përbëhet prej këtyre lagjeve urbane: Nakarada, Uglari, Bresja si dhe vendbanimeve Lismiri dhe Kuzmini.

Neni 3

Organizimi dhe struktura – përkufizimi

Për të realizuar sa më mirë funksionet e parapara me nenin 34, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë dhe nenit 17 të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Komuna e Fushë-Kosovës përbëhet prej qytezës së Fushë-Kosovës, 3 lagjeve të qytezës dhe 14 vendbanime fshatare (rurale).

Neni 4

Fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane, me pëlqimin e tyre, mund të bashkohen në organizime të përbashkëta dhe me këtë rast formojnë Bashkësinë e Përbashkët të fshatrave që bashkohen. Vendimin për bashkimin e tyre e miraton Kuvendi i Komunës, në bazë të kërkesës së tyre.

Neni 5

Organet e Bashkësive Vendore

- 5.1 Bashkësia vendore zgjedh Këshillin e Bashkësive Vendore dhe Kryetarin e *Bashkësive Vendore*, përmes votimit të fshehtë, apo të hapur në tubimin e qytetarëve.
- 5.2 Në përbërjen e Këshillit duhet të përfshihen së paku nga një përfaqësues i fshatit, vendbanimit, apo lagjes urbane, duke respektuar parimet e përfaqësimit gjinor.
- 5.3 Këshilli i Bashkësisë Vendore mund të ketë prej 5 deri në 17 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës.
- 5.4 Këshilli zgjedhet me mandat 3 vjeçar, ndërsa Kryetari i Bashkësisë Vendore zgjedhet me mandat 1 vjeçar.
- 5.5 Kryetari dhe anëtarët tjerë të Këshillit aktivitetin e tyre e zhvillojnë në baza vullnetare – me mundësi kompensimi me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.
- 5.6 Këshilli, anëtarët dhe Kryetari i Këshillit mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se kanë lëshime në punët e tyre.

Neni 6

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë:

- Nxjerr Rregulloren e Punës;
- Organizon, përcjell dhe planifikon zhvillimet e lokalitetit, në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, me Komitetet e tij dhe Drejtoritë e Komunës;
- Emëron Komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e lagjes urbane-lokaliteteve fshatare;
- Harton planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat, planifikon mjetet dhe shpërndarjen e tyre, sipas destinimit dhe vendimeve përkatëse të miratuara në Këshill, ose me deklaram me referendum të lokalitetit përkatës;
- Ndërmerr iniciativa përkatëse për destinimin dhe ruajtjen e objekteve në pronësi shtetërore dhe pasurive tjera të paluajtshme shtetërore në lokalitetin përkatës;
- Bën llogarinë 6 mujore dhe atë vjetore të mjeteve të inkasuara në BV dhe i bënë ato transparente, nëse ka ndonjë të hyrë nga burimet e mundshme të financimit për qytetarët e atij lokaliteti në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës.
- Siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen ekonomike të tyre dhe jep rekomandime e propozime, në lidhje me këto;

- Nga radhët e këshillit caktohet personi i cili do të ngarkohet me faturat për përcjelljen e gjendjes financiare të lokalitetit, sipas kategorive të cilat caktohen me vendim të posaçëm të Këshillit të lagjes (urbane) – përkatësisht të lokalitetit;
- Përveç kompetencave të numëruara në këtë nen Këshilli i BV nxjerr vendime dhe rekomandime.
- Në bazë të nevojave dhe të kërkesës së qytetarëve të BV, apo me iniciativën e Këshillit të BV, mund të përcaktohet grumbullimi i vetëkontributit të qytetarëve, në pajtueshmëri me dispozitat e Statutit të Komunës.

Neni 7

Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, koordinon punët në lagjet urbane dhe lokalitetet fshatare të Komunës së Fushë-Kosovës, përmes Kryetarëve të Këshillave të lagjeve dhe në bashkëpunim me Kuvendin, Komitetet e tij dhe Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, varësisht nga specifikat që do të trajtohen.

Neni 8

- 8.1 Për të gjitha punët e parapara, në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, Këshilli i Bashkësive Vendore përkatës mban obligime dhe përgjegjësi, në rast të keqpërdorimit eventual.
- 8.2 Përgjegjësia mund të jetë individuale apo kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

Neni 9

Me vendim të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, me kërkesën e Bashkësive Vendore, disa punë që janë në përgjegjësinë e Komunës mund të barten dhe të ushtrohen në Bashkësinë Vendore.

Neni 10

II DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Rregulloreje është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe ato të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 11

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së paraparë me Statutin e Kuvendit të Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës.

Neni 12

Kjo Rregullore hyn në fuqi, në ditën e miratimit, nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS

Nr.218 Datë15.10.2008

KRYETARI I KOMUNËS


BURIM BERISHA